



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel ndihmësakademik me karakter administrativ, bibliotekar, në sektorin e arkivimit, në Bibliotekën e Universitetit, në Rektorat.

Bibliotekar/arkivist: Zbaton procesin e modulit të qarkullimit; raporton periodikisht tek drejtori statistikën e ecurisë së punës; është pjesë e procesit të punës të inventarit fizik si dhe përditësimit të inventarit elektronik; përditëson bazën elektronike të njësive bibliotekare; përgjigjet për realizimin e detyrave të ngarkuara me përpikmëri dhe nivel të lartë profesional brenda afateve; zbaton çdo urdhër të posaçëm të drejtorit për situata të veçanta, urgjente e ngjarje të rëndësishme në jetën e Insitucionit.

Kandidati/a duhet të plotësojnë kriteret të përgjithshme e të posaçme, për këtë pozicion pune, si më poshtë:

Kriteret të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar dhe të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Të plotësojë kriteret e posaçme.

Kriteret të posaçme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të parë/dytë Bachelor/Master ose ekuivalente me të, në shkenca edukimi/shoqërore. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- Të ketë përvojë pune;
- Të ketë kryer kurse apo kualifikime në fushën e arkivimit brenda/jashtë vendit.
- Të jetë njohës i një prej gjuhëve të huaja të BE-së;
- Të ketë aftësi të mira, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë **në rrugë postare**, për periudhën **13.07.2026 – 22.07.2026**, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular aplikimi (gjendet në www.edu.al);
- Jetëshkrim i detajuar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Kopje të diplomave, listës së notave dhe certifikatave të noterizuara. Diplomat e lëshuar nga institucionet e huaja, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga ministra përgjegjëse për arsimin;
- Dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve, publikimeve ose veprimtarive profesionale, sipas kriterëve të shpallura;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, jo më e vjetër se 3- muaj nga data e aplikimit;
- Raport i aftësinë për punë, jo më e vjetër se 3- muaj nga data e aplikimit;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Certifikatë personale dhe familjare
- Çdo dokument që përmbush kriteret e përcaktuara në shpalljen e konkursit.

Të interesuarit duhet të dërgojnë dokumentacionin **në rrugë postare**, brenda periudhës **13.07.2026 – 22.07.2026**, në adresën si më poshtë:

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

APLIKIM PËR POZICIONIN E PUNËS: Bibliotekar

KATEGORIA: Personel ndihmësakademik.

DATA E DORËZIMIT: _____.____.2026

Konkursi do të zhvillohet në Rektoratin e UE-së. Komisioni ad-hoc do të verifikojë dhe vlerësojë paraprakisht dokumentacionin. Kandidatët që plotësojnë kriteret e shpallura, kalojnë në fazën e intervistës. Konkursi do të zhvillohet për periudhën 24.07.2026 – 05.08.2026. Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit dhe më pas shpalljen /njoftimin e fituesit.